REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 151/17
Datë/Datum. 28.06.2016
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW

PSH. Nr. 151/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, në përbërje prej: z. - Nuhi Paqarizi Kryetar, z. Tefik Sylejmani– Referues, z. Blerim Dina – anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE **"Marisa&Benita"** - Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Mirëmbajtja e gjelbërimit të qytetit dhe mbjellja e fidanëve të drunjve dekorativ"**, me numër të prokurimit: 632/16/080/211, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna Gjakovë**, më: 19.06.2017, mori këtë :

V E N D I M

I. **VËRTETOHET,** vendimi i **AK - Komuna Gjakovë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Mirëmbajtja e gjelbërimit të qytetit dhe mbjellja e fidanëve të drunjve dekorativ"**, me numër të prokurimit: 632/16/080/211, për anulim të këtij aktivitetit të prokurimit.

II. **REFUZOHET**, si e pa bazuar ankesa e OE **"Marisa&Benita"** - Gjakovë, lidhur me procedurën e prokurimit me titull: **"Mirëmbajtja e gjelbërimit të qytetit dhe mbjellja e fidanëve të drunjve dekorativ"**, me numër të prokurimit: 632/16/080/211.

III. Meqenëse pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues "Marisa&Benita" - Gjakovë janë të paqëndrueshme, konform nenit 118 të LPP-së, i behet konfiskimi i sigurimit te ankesës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë është bërë me dt: 19.12.2016, ndërsa hapja e ofertave është bërë me dt:30.01.2017, ndërsa në këtë aktivitet të prokurimit kanë marr pjesë gjashtë operatorë ekonomik.

Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit ne ueb faqen e Krpp-se, është bërë me dt: 11.05.2017.

Kërkesa për rishqyrtim nga ana e operatorit ekonomik "Marisa&Benita", është bërë konform nenit 108/A te LPP-se. Vendimi në lidhje me kërkesën për rishqyrtim ku është marr brenda afatit te paraparë me ligj.

Operatori ekonomik "Marisa&Benita" - Gjakovë, si palë e pakënaqur ka deponuar ankesë në OSHP më 23.05.2017, me nr. të protokollit, 151/17, kundër njoftimit për anulim te Aktivitetit te prokurimit, duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të LPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së nr. 04/L-042, ka autorizuar ekspertin shqyrtues, për të shqyrtuar procedurën e zhvilluar lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, si dhe vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues, në raportin e datës: 02.06.2017, ka konstatuar se AK-ja, i ka respektuar dispozitat e LPP-së dhe se pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë janë të paqëndrueshme, për faktin se OE ankues ka gabime aritmetike mbi 2% te vlerës se ofertës. Prandaj, në fund eksperti shqyrtues, duke u bazuar në sqarimet e dhëna në raport të ekspertizës i ka propozuar panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pa bazuar dhe njëherit i ka propozuar panelit shqyrtues që vendimi i AK-së për anulim te aktivitetit të prokurimit të mbetet në fuqi.

OE ankues "Marisa&Benita" - Gjakovë, përmes parashtresës e ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues, te datës 02.06.2017.

AK-ja, poashtu, me anë të parashtresës e ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me raportin dhe konstatimin e ekspertit shqyrtues, për këtë aktivitet të prokurimit.

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit te shkresave te lendes, vendosi qe konform nenit 28.1 te Rregullores se Punës se OSHP-se, te mbaj seance pa prezencën e palëve për faktin se palët pas pranimit te raportit nuk kanë ofruar prova te reja lidhur me këtë aktivitet te prokurimit.

Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor, më 19.06.2017, në të cilën ishin prezent anëtarët e Panelit shqyrtues dhe eksperti shqyrtues. Në seancë u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, përgjigjja e AK-së mbi raportin e ekspertizës.

Në vazhdim fjala iu dha ekspertit shqyrtues z.Basha i cili deklaroj: Qëndroj pranë raportit të ekspertizës, konstatimeve dhe rekomandimeve të dhëna në raportin e datës: 02.06.2017.

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, raportit të vlerësimit të komisionit vlerësues të AK-së, shqyrtimit të pikës pretenduese të parashtruesit të ankesës, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, të cekur në ekspertizë, parashtresës së OE ankues, parashtresës së AK-së, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, konstaton dhe vlerëson se AK-ja në harmoni me nenin 59 të LPP-së, ka bërë Vlerësimin, Ekzaminimin dhe Krahasimin e ofertave, për faktin se gjatë ekzaminimit të ofertave financiare të OE-ve, pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, komisioni Ri-vlerësues i ofertave ka vërejtur të gjitha gabimet aritmetike të operatoreve ekonomik ankues, gjithashtu me të drejt AK-ja ka konstatuar se edhe OE ankues ka gabime aritmetike mbi 2% të vlerës së ofertës. Prandaj, paneli shqyrtues konstaton dhe vlerëson se OE ankues është i papërgjegjshëm për faktin se nuk lejohet të ketë gabime aritmetike me shume se 2% të vlerës së ofertës, sipas nenit 59.3: Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përqind

(2%) i vlerës totale të ofertës

Prandaj Paneli shqyrtues, duke u bazuar në nenin 117 të LPP-së, si dhe duke u mbështetur në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike :
Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur
nuk mund të ushtron ankesë,
por për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh,
pas pranimit të këtij vendimi, mund të ngritë
kërkesë-padi në Gjykatën Themelore - Prishtinë
Departamenti për Çështje Administrative.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Nuhi Paqarizi